



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**

**PROCUREMENT REVIEW BODY**

---

Duke u bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publikë Nr. 06/L-114, nenit 32 pika 4, nenit 66 pika 2, pika 3, pika 3.1, pika 4, si dhe nenit 81 pika 2, pika 2.1, **Organi Shqyrtues i Prokurimit** shpall këtë:

## **K O N K U R S**

**2.Titulli i punës :** Një (1) Zyrtar/e i/e Lart Ligjor  
**Koeficienti :** 8  
**Lloji i pozitës :** Niveli Profesional (Zavendësim në kohëzgjatje prej një (1) viti)  
**Orari i punës :** 40 orë në javë  
**Mbikëqyrësi :** Udhëheqës i Divizionit të Brendshëm  
**Vendi :** OSHP-Prishtinë

### **Qëllimi i vendit të punës:**

Hartimi, zhvillimi dhe harmonizimi i legjislacionit dhe akteve tjera juridike si dhe dhënia e këshillave për menaxhmentin dhe njësitë organizative të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e objektivave të njësisë;
- Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën specifike si dhe ndihmon stafin tjetër të institucionit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësisë dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet;
- Harton akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Është përgjegjës për pajtueshmërinë e akteve nënligjore me Kushtetutën dhe me legjislacionin në fuqi në Republikës e Kosovës;
- Bën rishikimin ligjor dhe gjuhësor, siguron që përmbajtja ligjore dhe teknike të jetë e saktë dhe identike në të tri gjuhët zyrtare, si dhe përcjell dhe menaxhon procedurat e hartimit dhe dorëzimit të projektligjeve në Qeveri;
- Bën hulumtime dhe analiza të ndërlidhura me ligjet dhe aktet nënligjore brenda fushës së përgjegjësisë dhe jep rekomandime, këshilla, udhëzime për menaxhmentin e institucionit
- Kryen edhe detyra tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

#### **Kualifikimet, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

- Diplomë universitare, fakulteti juridik, minimumi 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);
- Njohuri të mira të gjuhës angleze, e dëshirueshme.

#### **Procedura e Rekrutimit :**

**Konkursi**, është i hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit, është (Zavendësim), me kohëzgjatje prej një (1) viti, derisa të kthehet nga pushimi i Lehonisë Zyrtarja e Lartë Ligjore.

#### **Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:**

Formularët për aplikim mund të merren në Organin Shqyrtues të Prokurimit/Zyra e Personelit, (Adresa : Rruga "Migjeni" ish-Ndërtesa e Bankës së Lublanes, Kati i- V-të , Prishtinë), ose tërhiqen nga ueb faqja zyrtare e Organit Shqyrtues të Prokurimit, ku është bërë edhe shpallja e konkursit, në adresën <http://oshp.rks-gov.net/> dhe dorëzohen në Zyrën e

Personelit në Organin Shqyrtues të Prokurimit, netçdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, ose në e-mailin : arta.S.berisha@rks-gov.net.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038/212-360 ose përmes, e-mailit : arta.S.berisha@rks-gov.net.

Formulari zyrtar i konkurrimit duhet të dorëzohet së bashku me dëshminë për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, përvojën e punës, certifikatën (dëshminë) që s'është nën hetime dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

***“Organi Shqyrtues i Prokurimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjithë komunitetet e Republikës së Kosovës”.***

***“Komuniteti jo – shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.***

***Komunitetet jo-shumicë dhe pjesorët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.***

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijn brenda 3 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Kandidatët të cilët hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

**Afati i konkursit është i hapur 8 ditë nga data e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Organit Shqyrtues të Prokurimit, prej datës : 31.03.2021 deri më datën: 07.04.2021 në ora 16:00).**



